



REPUBLIKA E SHQIPERISE

ORGANI SHTETËROR I AUTORIZUAR  
PËR MARRËVESHJEN E KONCESIONIT ME SHOQERINË "ROMANO PORT" SHA.

MINISTRIA EKONOMISE, TREGTISE  
DHE ENERGJETIKES

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Nr. 888 Prot., Tiranë, më 04/09, 2009

Nr. 5204 Prot., Tiranë, më 7/9, 2009

MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE  
DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE

Nr. 1688 Prot., Tiranë, më 10/09, 2009

VENDIM

Nr. 6, datë 01.09, 2009

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) në Marrëveshjen e Koncesionit të formës BOT me shoqërinë "Romano Port" sha., të ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 9298, datë 28.10.2004 "Per ratifikimin e Marrëveshjes së Koncesionit, të formës "BOT" për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durres", ndryshuar me ligjin Nr. 9578, datë 11.7.2006., në mbledhjen e tij të datës 01. 09. 2009, morri në shqyrtim:

1. Propozimin e paraqitur pranë OSHA-së nga shoqëria koncesionare "Romano Port" sh.a., per nje plotesim te tabelës ekzistuese të tarifave të shërbimit në Portin e nënprodukteve të naftës dhe lëndëve djegëse të Porto Romanos edhe me disa tarifa të tjera (shkresat e saj nr. 39 prot., datë 06. 03 2009, nr. 81 prot., date 29.07.2009 dhe nr. 90 prot., date 25.08.2009)
2. Kërkesen e koncesionarit "Romano Port" sh.a. per te marre miratimin e OSHA-se, per ndertimin dhe funksionimin e laboratorit per kryerjen e analizave të cilësisë për produktet që do të shkarkohen/ngarkohen në port.

OSHA-ja, duke konstatuar e konsideruar se:

**1. Per çeshtjen e tarifave:**

- Tarifat shtese qe kerkohen te miratohen nuk jane pjese e propozimit te meparsheshem te shoqerise (Nr. 5, dt. 19.01.2007) dhe rrjedhimisht nuk jane perfshire ne Tabelen "Tarifat e shërbimit në Portin e Hidrokarbureve të "Romano-Port" sha. Porto-Romano, Durres", miratuar nga OSHA-ja, me vendimin e saj Nr. 3, date 4.03.2009;

- Ndikojne po ata faktore qe percaktuan tarifat e tjera te sherbimit ne kete port, per te argumentuar nivelet e tarifave qe propozon shoqeria "Romano Port" Sh.a.

-Propozimi per tarifat shtese eshte ne perputhje me percaktimin e "Aneksit 4" te Marrveshjes se Koncesionit dhe me pikën 2 të "Marrveshjes Shtese" të miratuar me Ligjin Nr. 9578, datë 11.7.2006

## 2. Per çeshtjen e laboratorit

-Praktika aktuale, sipas së cilës kampionet e analizave merren në anijen e ankoruar në Platformë nga inspektorët e IQT dhe më pas dërgohen për t'u analizuar në Laboratorin e IQT në Tiranë, rezultun se është një praktikë që kërkon mjaft kohë dhe për pasojë nuk është efektive.

-Sipas Marrveshjes së Koncesionit me shoqërinë "Romano Port" sh.a., por edhe sipas praktikave ndërkombëtare në kryerjen e shërbimit të përpunimit të anijeve në portin e naftës, përfshihet edhe "Shërbimi i kontrollit të peshmatjes dhe laboratorit i cilësisë së karburanteve, GLN dhe të nënprodukteve të tyre". (Pika 2.8 e Aneksit 2, si dhe pika 2.7 e Aneksit 4 të Marrveshjes).

-Kerkohet marrja e masave te menjehershme per shkurtime e kohes se kryerjes e analizës së cilësisë për produktet që do të shkarkohen/ngarkohen në port, problem ky me ndikim direkt në shfrytëzimin me efikasitet të lartë të portit të naftës, nderkohe qe lidhet drejperdrejt me pagesat qe kryhen nga subjektet ne raport me anijen.

-Vlereson kerkesen e koncesionarit per realizimin e shërbimit të analizave në port nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të laboratorit përkatës, gjë e cila është parashikuar edhe në "Rregulloren e funksionimit të portit".

Si dhe bazuar në klauzolat e Marrveshjes së Koncesionit, të ndryshuar

## VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat shtese ne tabelën e "Tarifave te shërbimit në Portin e Hidrokarbureve të "Romano-Port" sh.a, Porto-Romano, Durres", miratuar me vendimin e saj Nr. 3, date 4.03.2009, si me poshte:

Nr.	Emertimi i sherbimit	Tarifa
17	Për qëndrimin në kalatë të anijes gjatë ngarkim/shkarkimit (per 1 metër linear të anijes për 24 orë)	3,85 Euro/meter linear
18	Sherbim i mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpetimit te anijes (lekë/ore)	5000 leke
19	Për sigurimin (security) e anijes per ton mall*	51 leke/ton
20	Shkarkimi per 1 ton mazut	8,2 Euro
21	Shkarkimi per 1 ton bitum i lëngët i naftës	8.2 Euro

\* Paguhet nga pritësi i mallit.

2. Te ngarkoje koncesionarin "Romano Port" sh.a.te publikoje ne faqen e internetit te shoqerise edhe tarifat shtese te mesiperme.
3. Te jape miratimin per ndertimin dhe funksionimin e labororit në Portin e "Porto Romano", per kryerjen e analizave të cilësisë për produktet që do te shkarkohen/ngarkohen në port.
4. Te ngarkoje koncesionarin "Romano Port" sh.a. qe, krahas ndertimit dhe paisjes se labororit, te filloje procedurat e akreditimit te tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për OSHA-në:

Ministër i Ekonomisë, Tregtisë  
dhe Energjetikës

Genç RULI



Ministër i Punëve Publike,  
Transportit dhe Telekomunikacionit

Sokol OLEDASHI



Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe  
Administrimit të Ujreve

Lufter XHUVELI

